



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:196713

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05875652

KF.nr.438/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “N.H.K.” B.I., me numër unik identifikues 810429606 dhe seli në rr. “Zahir Pajaziti”, Podujevë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me bazë juridike anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, vlera e kontestit e papërcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik me datë 20.06.2024, të mbajtur në prani të palës paditëse N.K., e në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZHET kërkesëpadia e paditësit “N.H.K.” B.I. me numër unik identifikues 810429606 dhe seli në rr. “Zahir Pajaziti”, Podujevë, si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi Vendimi nr. 507/2019 të datës 12.12.2019 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.
- III. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 03.09.2021, ka iniciuar kontestin tregtar-administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me të cilën ka kërkuar të mos llogaritet si e hyrë për paditësin pjesa e qerasë nga TEB Bank në Podujevë e cila është transferuar për bashkëshorten, të shpërndajë tatimin e mbajtur në burim për qera sipas ndryshimit të shpërndarjes së të hyrave dhe të konsiderojë se janë plotësuar kushtet që pas pranimi të pikës 1 të bëhet çregjistrimi nga TVSH retroaktivisht sipas plotësimit të kushteve. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbesin pranë padisë dhe kërkesëpadisë. Duke

precizuar kërkesëpadinë ashtu që nga Gjykata ka kërkuar që të anulohet aktvendimin e kontestuar të DA ashtu që të detyrojë të paditurën të mos llogarit si të hyrë për N.K. pjesa e qirasë nga Teb Bank e cila është transferuar për bashkëshorten dhe të obligojë të paditurën t'i kthej paditësit pjesën e paguar dy herë për tatimin në burim si dhe TVSH-në e paguar për këtë pjesë si dhe t'i kthej shumën e paguar në emër të ndëshkimeve në prej 25% nga baza tatimore. Ka shtuar se tatimi në burim i cili tashmë i është ndalur bashkëshortes së paditësit për të njëjtën pronë ATK ka ngarkuar këtu paditësin e që rrjedhimisht i bie se dy herë është paguar tatim i njëjtë. Po ashtu për qiradhënien e tokës ATK i ka ngarkuar tre persona paditësin dhe dy vëllezërit e paditësit, mirëpo ky tatim në total tashmë ishte i paguar nga vëllai i paditësit A.K. ndërsa ATK në kontroll sërish e ka ngarkuar paditësin me tatim për të njëjtën pronë. idhur me kontestin e paditësit për trajtimin e qiradhënies së tokës si e hyrë e liruar nga TVSH-ja, Administrata Tatimore, pas analizimit të shkresave të lëndës dhe bazuar në dispozitat ligjore që e rregullojnë çështjen në fjalë, vërteton se vlerësimi i kontrollit është i drejtë dhe bazuar në ligjin dhe atë në nenin 28 paragrafin 5, nën paragrafin 1.11, dispozitë e cila parasheh: "Furnizimi i shtëpive, banesave ose të ngjashme, që shfrytëzohen për qëllime të banimit, duke përfshirë garazhet dhe bodrumet." ATK-ja konstaton se paditësi/tatimpaguesi, me rastin e dhënies së tokës me qira subjektit Raiffeisen Bank, ku e njëjta është shfrytëzuar për qëllime të aktivitetit ekonomik - parking, nuk bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lart. Një tjetër pikë kontestuese e paditësit është edhe shpërndarja e tatimit të mbajtur në burim mbi qiranë sipas shpërndarjes së të hyrave të pranuar nga qiraja. ATK-ja, nga analiza e dosjes në dispozicion, konstaton se tatimpaguesi për të hyrat e krijuara nga qiraja dhe atë si bashkëqiradhënës për lokalin për Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C., po ashtu si bashkëqiradhënës për parkingun e lëshuar me qira për TEB Bankë, si dhe për lëshimin e objektit me qira për TEB Bankë në Podujevë, për të cilën qira nuk ju është mbajtur tatimi në burim qiradhënësi legjitim N.K., sipas kontratës së qiradhënies, konstatohet se mbetet në fuqi vlerësimi i kontrollit. Administrata Tatimore konstaton se paditësi për të hyrat e krijuara nga qiraja nuk ka arritur të argumentojë se ka mbajtur Tatimin e Mbajtur në Burim nga qiramarrësi për të cilën ka qenë i obliguar sipas dispozitave ligjore, gjegjësisht Ligjit Nr.05/L-028 për Tatim në të Ardhura Personale, neni 39 si dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016. Pretendimi tjetër i paditësit është edhe kërkesa që, nëse shpërndarja është e pamundur teknikisht, të mundësohet transferimi debi - kredi i mbi pagesave te personi te i cili qiramarrësit i kanë mbajtur tatimin në burim për tërë vlerën e të hyrave sipas kontratave të qiradhënies, pra për subjektin A.K.. ATK-ja - kontrolli, bazuar në Ligjin 03/L-222, neni 30 paragrafin 1, konstaton se pretendimi i tatimpaguesit është i drejtë, mirëpo meqenëse kemi të bëjmë me dy biznese të ndryshme, si dhe duke pasur parasysh se biznesi individual A.K. ka pasur kontroll tatimor nga

ana e Administratës Tatimore atëherë pretendimin e tillë tatimpaguesi ka mundur ta paraqes me një ankesë drejtuar Divizionit të Ankesave apo paraqet kërkesë për transfer debi-kredi tek Divizioni i Shërbimit të Tatimpaguesve në kuadër të ATK-së. Me parashtrësën e datës 18.06.2024 gjykatën ne ka njoftuar se nuk do të prezantojë në seancë, me kërksë që gjykata të refuzojë kërkesëpadinë si të pabazuar dhe të lë në fuqi vendimin e kontestuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 08.02.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi kontestues nr. 192/2021 dt 02.08.2021, Ankesë ndaj raportit të kontrollit, Raporti i kontrollit për paditësin dhe Raporti i kontrollit për A.K. B.I, Përgjigja në padi datës 14.12.2021, certifikatë e mbajtjes në burim të tatimit mbi interesin, të drejtat pronësore, qiratë, jo rezidentet dhe kategoritë e veçanta (T/P Raiffeisen Bank), Certifikata e mbajtjes në burim të tatimit mbi dividetët, interesin, të drejtat pronësore, fitimet në llotaritë dhe qiratë e datës 07.04.2021, Kontratë për qira komerciale dhe shtojca nr. 5 e kontratës, Gjendja e borxheve në ATK.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Gjykata nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga Raport kontrolli i ATK-së, deklarimeve në ankesë, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi-subjekti ekonomik N.K. B.I. i është nënshtruar kontrollës nga e paditura. Kontrolli është kryer për periudhën TVSH 05/2015-12/2020, IR 06/2015 -12/2020 dhe IS 06/2015-12/2020, ndryshimet pas kontrollit tatim shtesë në TVSH në vlerë prej 41,086 euro dhe ndëshkim prej 25 % në shumë prej 8737 euro si dhe tatimi mbi qiranë dhe pasuritë e patrupëzuara IR, tatim shtese 18,439 euro dhe ndëshkim 25 % ne shume prej 4609 euro.

Tatimpaguesi i pakënaqur me rezultatet e kontrollit të kryera nga ATK-ja ka ushtruar ankesë në Departamentin e ankesave ndaj njoftimit rivlerësim te ATK-se. Pas shqyrtimit të ankesës nga Departamenti ankesave me vendimin kontestues, e paditura ka aprovuar pjesërisht ankesën duke ndryshuar njoftim rivlerësimin duke pranuar si te zbritshëm tatimin e mbajtur ne burim mbi qiranë nga Raiffeisen Bank Kosova dhe atë për vitin 2018 tatimin ne vlerë prej 924.66

euro për vitin 2019 tatim në vlerë prej 958.28 euro si dhe për vitin 2020 tatimi në vlerë prej 1,008.72 euro, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit mbetet e pa ndryshuar, sipas vlerësimit të kontrollit. Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura thekson se kontrolli vlerësimin e ka mbështet në nenin 13, 14 dhe 15 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimor dhe Procedurat si dhe nenin 17 të Udhëzimit Administrativ 15/2010, me ç'rast tatimpaguesi është obliguar me tatim shtesë. Ndaj vendimit të DA-ATK, paditësi me padi ka iniciuar këtë konflikt administrativ.

Kontestuese në mes të palëve mbetet nëse tatimi i mbajtur në burim nga subjekti A.K. është trajtuar drejtë nga e paditura si dhe të hyrat nga qiraja sipas kontratës me TEB Bankë në Podujevë a duhet t'i kalkulohe si e hyrë N.K.t pasi që tashmë ato janë llogaritur si e hyrë e bashkëshortes për të cilën është mbajtur tatimi në burim.

Gjykata pas elaborimit të arsyetimit të vendimit kontestues, thëniet e palëve dhe provave të cilat gjenden në shkresë të lëndës, konstaton se, me vendimin e kontestuar e paditura ka konstatuar se vlerësimin e kontrollit e ka marrë të besueshëm pasi është vërtetuar gjendja e tatimpaguesit se kontrata me TEB Bankë ka qenë e lidhur në mes të këtu paditësit dhe TEB Bank dhe se e paditura ka vepruar drejtë kur e ka ngarkuar të njëjtin me tatim në burim sipas nenit 39 të Ligjit 05/L-028 për Tatim në të Ardhurat Personale dhe UA nr.01/2016.

Me nenin 39 të Ligjit 05/L-028 për Tatim në të Ardhurat Personale, par. 1 është përcaktuar se: *“Tatimi i mbajtur në burim në interes, në të drejta pronësore dhe në qira 1. Secili person fizik afarist, ortakëri apo grupim i personave, i cili iu paguan interes apo të drejta pronësore, përveç interesit që është i liruar sipas këtij ligji, personave rezidentë apo jo rezidentë, do të mbajë në burim tatimin dhjetë për qind (10%) në kohën e pagesës apo kreditimit.*

Po ashtu arsyetimin e të paditurës lidhur me pretendimet e paditësit se A.K., vëllau i këtu paditësit ka paguar tërë tatimin në burim, kur ka theksuar se pretendimet tatimpaguesi ka mundur të paraqet në ankesën drejtuar Divizionit të Ankesave apo të paraqet kërkesë për transfer debikredi tek Divizioni i Shërbimit të Tatimpaguesvje, i mori si të bazuara.

Gjykata konstaton se paditësi obligohet të paguaj tatimin në burim si bashkë kontraktues i kontratës së cekur, dhe se A.K. ka mund të kërkojë kthimin e mjeteve të paguara më tepër e e kjo konform nenin 30 të Ligjit 03/L-222 me të cilin përcaktohet se *1. Çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj*

detyrimin aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute pensionale. ATK-ja do t'i dorëzojë tatimpaguesit njoftim më shkrim aty ku pagesa e tepërt është përdorur për mbulimin e një detyrimin tjetër, duke e informuar tatimpaguesin për shumën e kreditimit të aplikuar, tatimin dhe periudhën tatimore. 2. Në rastin kur tatimpaguesi nuk ka detyrime tjera ndaj ATK-së, ose kur ka mbetur një shumë tepricë nga tatimi i mbi paguar, pasi teprica e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni është përdorur për të shlyer detyrimet e tjera tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë t'i kërkojë ATK-së rimbursimin e shumës së mbetur. 3. Kërkesa për kreditim ose rimbursim për një pagesë të tepërt të çfarëdo lloji të tatimit mund të dorëzohet brenda gjashtë (6) vitesh nga data kur është paguar tatimi. Procedura për aplikim të rimbursimit të tatimit do të rregullohet me akt nënligjor. 4. ATK-ja do të veprojë lidhur me kërkesën e lejueshme për rimbursim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data kur ka pranuar kërkesën nga tatimpaguesi, duke siguruar që detajet e shumës për rimbursim i janë përcjellë me kohë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ose me rastin e kontributeve pensionale, në Trustin e Kursimeve për Pensione të Kosovës. 5. Në rastin kur tatimpaguesi ka të drejtë në rimbursim sipas paragrafit 2. të këtij neni dhe ky rimbursim nuk është zbatuar brenda kohës së paraparë në paragrafin 4 po të këtij neni, ATK-ja do t'i paguajë tatimpaguesit, përveç shumës së përcaktuar nga ATK për rimbursim edhe interesin në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Kur ATK të përcaktojë se nuk duhet të lëshohet një rimbursim, apo duhet të mbahet për arsye administrative në përputhje me ligjin e aplikueshëm, interesi nuk do të jetë obligim në shumën që nuk është lëshuar apo nuk është mbajtur. 6. Interesi sipas paragrafit 5. të këtij neni, do të fillojë të rrjedh nga dita e gjashtëdhjetenjë (61) nga data e parashtrimit të kërkesës për rimbursim”.

Gjykata nuk e pranon si të bazuar pretendimin e paditësit se të hyrat nga kontrata e qirasë i janë transferuar bashkëshortes e cila ka mbajtur tatim në burim. Ky pretendim është i pabazuar për shkak se e paditura argumentoi se nga vetë TEB Banka është njoftuar se kontrata është nënshkruar me N.K., duke bërë kështu që ai të jetë i obliguar të paguaj tatimin në burim. Pretendimi se të hyrat janë transferuar te bashkëshortja kjo gjykatë nuk e mori si të bazuar, pasi paditësi nuk arriti të dëshmojë se TEB Banka është nënshkruese e kësaj marrëveshje dhe se nga Raporti i Kontrollit rezulton se të hyrat janë në emër të N.K.. Kjo nënkupton se palët kontraktuese janë TEB Banka dhe paditësi, dhe jo bashkëshortja, e cila nuk është nënshkruese e kontratës me TEB Bank.

Nga kjo gjendje e fakteve, gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe raportin e kontrollit dhe se dëshmitë e paraqitura nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative.

Në mungesë të provave të cilat do të dëshmonin aplikimin e drejtë të dispozitave të lartcekura nga këtu paditësi, gjykata nuk mundi të vendos ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi. Prandaj, në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të provave, gjykata konstaton se vendimi i Departamentit të Ankesave të ATK-së me nr. 192/2021 i datës 02.08.2021 është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës si në pikën III të këtij aktgjykimi, Gjykata e mori konform nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të lartcekurat, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 46 par 1 dhe 2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij atkgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.438/22, datë 20.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.